



KUVENDI

Në bazë të neneve 12 paragrafi 2 shkronja d, 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 10 paragrafi 1.5 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, nenin 20 paragrafi 11 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 15 paragrafi 15.2 shkronja d, 17.1 dhe 56 shkronja h të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2015, miratoi,

VENDIM

PËR DHËNIEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE - KEDS

Neni 1

Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, për ndërtimin e Trafostacioneve të reja sipas planeve investive për zgjerim dhe përfundim të rrjetit distributiv, i jepen në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të Komunës, të evidentuara në:

- Certifikatën nr.08-714-7964/2015, pjesa e ngastrës kadastrale nr. 842-0, kultura kullosë në sipërfaqe, në sipërfaqe prej 4 m², vendi i quajtur Gjelbishtë, Zona kadastrale Lupç i Poshtëm, dhe
- Certifikatën nr-08-714-785/15, pjesa e ngastrës kadastrale nr. 196-0, kultura rrugë publike në sipërfaqe, 8 m², Zona kadastrale Letanc.

Neni 2

Paluajtshmëritë e cekura jepen për ndërtimin e trafostacioneve të reja TSSH 10(20)/0.4kv 160 (kvA) dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera.

Neni 3

Afati i dhënies në shfrytëzim është 40 (dyzetë) vite.

Neni 4

Shfrytëzimi i pronave sipas këtij vendimi jepet pa kompensim.

Neni 5

Kontratat për dhënie në shfrytëzim të pronave, pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i KEDS-it.

Neni 6

Dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të Komunës për raste të veçanta evidentohen në Regjistrin e të drejtave pronësore në elaboratin kadastral.

Neni 7

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 8

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 01-463-92251 i datës 14 nëntor 2014

Neni 9

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-16477
Podujevë,
4 shkurt 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi